



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:190398

Datë: 17.12.2024

Numri i dokumentit: 06608899

C.nr.2151/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridiko-civile të paditëses Kompania e Sigurimit „Eurosig”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari Vedat Kerolli, nga Prishtina, kundër të paditurit G.C., nga P., të cilin e përfaqëson Besnik Nikqi, avokat në Prishtinë, për shkak të rimbursimit të dëmit, vlera e kontestit 2.646€, në seancën e shqyrtimit kryesor, të mbajtur me dt.04.12.2024, në prezencë të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, dhe të paditurit, me dt.12.12.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve „Eurosig”, Sh.a., me seli në Prishtinë, ashtu që:

I. DETYROHET i padituri G.C., nga P., që paditëses në emër të regresimit të mjeteve, t'ia paguaj shumën në lartësi prej 2.646€, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit me dt.12.12.2024, si ditë e vendim marrjes e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 40€, të gjitha këto në afat prej 15 dite, e nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, me padi gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e nëpërmjet të autorizuarit të saj, ka parashtruar se me dt..... në rrugën „Bajram Kelmendi”, në Pejë, i padituri duke drejtuar automjetin „VW”, në drejtim të Spitalit të Pejës, pa poseduar patentë shofer, ka shkaktuar aksident trafiku, dhe si pasojë e këtij aksidenti, i ka shkaktuar dëm material, dhe lëndime trupore ka pësuar drejtuesja e automjetit Venera Gashi,

Ka theksuar se automjeti, me të cilin është shkaktuar aksidenti në fjalë, në momentin e ndodhjes së aksidentit, ka pas të kontraktuar policen nga Autopërgjegjësia me të siguarin G.C., nga P.,.....

Ka potencuar se baza juridike e kërkesëpadisë është e bazuar dhe mbështetet në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 9, 136 par.1, lidhur me nenin 159, neni 169 par.1, lidhur me nenin 174, neni 378 lidhur me nenin 382 dhe neni 281, lidhur me nenin 960 par.1, dhe Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, neni 2 par.1 pika 10, neni 3 par.1, neni 10 si dhe neni 14. Për dëmet e shkaktuara palëve të treta, ku si të dëmtuar janë: V.G. etj, dhe atë në shumën e përgjithshme prej 2.646€, që ju është shkaktuar si pasojë e aksidentit të lartcekur. Se këtë aksidenti e ka shkaktuar i padituri, me përdorimin e automjetit të cekur me lartë, dhe ishte pa patentë shofer, andaj duke marr për bazë këto rrethana, kanë propozuar që pas administrimit të provave nga padia, gjykata kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Gjatë shqyrtimit kryesor ka mbetur pranë kërkesëpadisë dhe ka parashtruar parashtrësën me dt.19.11.2024, ku ka ritheksuar se nuk qëndrojnë thëniet e palës së paditur, se në rastin konkret mungon legjitimiteti aktiv dhe pasiv se bazuar në shkresat e lëndës, i padituri ka drejtuar automjetinpa patentë shofer, dhe i'u ka shkaktuar palëve të treta, se i padituri ka

vepruar në kundërshtim me ligjin, me rastin e drejtimit të automjetit motorik, pa patentë shofer, e që për pasojë, pala paditëse është detyruar që palëve të treta të dëmtuara t'ju kompensoj dëmet që i'u janë shkaktuar, dhe ka fituar të drejtën që ato t'i rimbursoj nga i padituri.

Në fjalën e saj përfundimtare, ka ritheksuar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, si dhe të gjitha deklarimeve nga seancat e kaluara dhe parashtresës së fundit të dt.19.11.2024, duke kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesën e saj t'a aprovoj në tërësi si të bazuar, duke detyruar të paditurin që ta përmbush borxhin në vlerën prej 2.646€. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për taksë gjyqësore dhe atë shumën prej 40€, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë deri në pagesën përfundimtare.

I padituri me përgjigje në padi të dhënë me shkrim me dt.21.05.2024, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e përmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar se nuk i janë dorëzuar me kohë provat nga padia.

I padituri e ka kontestuar bazën e kërkesëpadisë, me arsyetim se paditëses i mungon legjitimiteti aktiv, për të parashtruar një kërkesë të tillë...duke e mbështetur në dispozitën e nenit 2, pika 1.10, nenit 3 pikë 1, nenit 10 dhe nenit 14, se të tria këto dispozitat, nuk justifikojnë fare bazën e kërkesëpadisë dhe as që kanë të bëjnë me bazën juridike të rimbursimit të pretenduar...

Ka theksuar se rasti konkret i shkaktimit të dëmit, është rast kur kemi të bëjmë me drejtuesin e paautorizuar të mjetit motorik, e që është e vërteta, këto raste gëzojnë mbulesë siguroese. Se nëse në rastin konkret do të pretendohet në ndonjë rimbursim në raport me drejtuesin e paautorizuar-të paditurin, ky mund të jetë vetëm pronar i automjetit-i siguruari nga policia TPL, e të cilit janë paguar zhdëmtimet, përkitazi më të cilat kërkohet rimbursim, dhe mbi këtë bazë të njëjtë, është caktuar primë më i lartë në katër vitet e ardhshme. I padituri objektivisht si drejtues i automjetit, as që kishte mundësi që të jetë i pajisur me patentë shofer, nisur nga fakti se dëmi ishte shkaktuar kur ai ishte i moshës 15 vjeçare...

Gjatë shqyrtimit kryesor ka mbetur pranë thënieve të përgjigjes në padi.

I aut. i paditurit, në fjalën e tij përfundimtare, të përgatitur edhe me shkrim, për gjykatën dhe palën tjetër, ka ritheksuar se nga provat e administruara është vërtetuar gjendja faktike e tillë, se rasti konkret i referohet ekskluzivisht dispozitës së nenit 9 pika 1 pikë 3 të Ligjit Nr.04/L-018, ku ex lege është konfirmuar mbulesa siguroese në këto raste, andaj edhe mungon, respektivisht nuk kemi dispozitë që siguruesi TPL/paditësit i takon ndonjë e drejtë e rimbursimit, se provat për inkasim të primit të shtuar, të cilat u administruan, konfirmojnë gjithashtu ekzistimin e mbulesës siguroese.

Ka ritheksuar se i padituri me rastin e shkaktimit të aksidentit ishte në moshën 15 vjeçare, që objektivisht nuk kishte mundësi që të pajiset me patentë shofer...se nuk kemi të bëjmë me dëm të shkaktuar nga personi, që gëzonte statusin e të siguruarit(pronar, posedues), por rast ky ku automjeti është përdorur nga i padituri, si person i pa autorizuar...

Me tutje ka cekur se paditësi dështon në mbështetjen e kërkesëpadisë në bazë juridike, duke ju referuar dispozitës së nenit 14, i cili trajton rastet e humbjes së mbulesës siguroese, dhe në par.3 të nenit 14, instalon të drejtën në rimbursim në raport me të siguruarin e të listuar në pikën 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, e që në rastin konkret, i padituri nuk ka këtë status, andaj ka mbetur pranë përgjigjes në padi dhe fjalës përfundimtare që e ka dhënë me shkrim, për refuzimin e kërkesëpadisë si të pa bazuar. Shpenzimet i ka kërkuar sipas listës, dhe atë: .

Gjykata ka konstatuar se nga gjyqtari paraprak, është tentuar që kjo çështje të zgjidhet në procedurë të ndërmjetësimit, kur edhe të paditurit i është dorëzuar padia me prova, mirëpo gjykata gjatë shqyrtimit kryesor, edhe një herë të paditurit i'a ka dorëzuar të gjitha provat që i ka dorëzuar pala paditëse.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palës paditëse ka zhvilluar procedurën me ç'rast u administrua si provë: konfirmimi i sigurimit i dt.03.01.2020, 2 raporte të aksidentit të dt....., procesverbali

mbi vend shikimin e aksidentit i dt....., fotot nga vend shiqimi, marrëveshja jashtëgjyqësore, gjegjësisht marrëveshja me ndërmjetësim në lëndën C.nr.....dhe fotot e automjeteve të aksidentuara, marrëveshja jashtëgjyqësore e dt.16.01.2020 bashkë me shkresat përbërës të saj, kërkesa për regresim të dëmit e paditëses e dt.04.03.2020, parashtresa me pesë pagesa të primit të sigurimit të shtuara, e nxjerr në vitin 2024, deklaramet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, dhe të gjitha shkresat e lëndës.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjithave së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike-civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara gjykata ka konstatuar:

-se me....., pa poseduar leje të vlefshme për drejtimin e automjetit, ka shkaktuar aksident trafiku, dhe si pasojë e saj, ju ka shkaktuar dëm material të dëmtuarve dhe ate: V.G., për lëndime truporë shumë prej 1.304€ dhe për dëm në veturë, shumë prej 600€. Për L.L., për dëmtimet në veturë, shumë prej 120€, dhe për Sh.L., për lëndime trupore, shumë prej 621€.

Ky dëm, të dëmtuarve ju është trajtuar dhe paguar nga baza e sigurimit, që i referohet aksidentit të trafikut të cekur më lartë, e në shumë të tërësishme prej 2.646€, dëm ky i vërtetuar nga në bazë urdhërpagesës, respektivisht transaksionit bankar.

Po ashtu gjykata ka konstatuar se paditësja Kompania e Sigurimeve „Eurosig” Sh.a., me seli në Prishtinë, pasi që ka bërë marrëveshje jashtëgjyqësore për pranimin e vlerës së dëmit material dhe jo material, është detyruar që të dëmtuarve të cekur më lartë, për shkak të dëmit të pësuar në aksidentin e dt....., të shkaktuar nga i padituri G.C., nga P., i cili nuk ka poseduar patentë shofer për drejtimin e automjetit, t’iu paguaj shumat e cekura më lartë, secilit të dëmtuar veç e veç, që vërtetohet në bazë urdhërpagesave, marrëveshjeve jashtëgjyqësore.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që i padituri të jetë përgjegjëse për rimbursimin e dëmit paditëses, gjen mbështetje në dispozitat e nenit 9 dhe 14 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto-përgjegjësisë(Ligji nr.04/L-018), e lidhur me dispozitat e nenit 245, par.1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Paditësja, është dashur t’ju kompensoj dëmin të dëmtuarve, në aksidentin e komunikacionit rrugor të dt....., në bazë të dispozitës së nenit 9 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto-përgjegjësisë (Ligji nr.04/L-018) në të cilën shprehimisht parashihet se Sigurimi nga auto-përgjegjësia mbulon: *1.1. dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik. 1.2. dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjetit motorik, përfshinë gjithashtu dëmin e shkaktuar palëve të treta përmes gjësëndeve të cilat bien nga mjetet motorike apo çdo gjë tjetër që është i lidhur me mjetin motorik. 1.3. dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjetit motorik palëve të treta nga drejtuesi i paautorizuar i mjetit motorik.*

Meqenëse paditësja në bazë të provave prezentë në shkresat të lëndës e ka përmbushur detyrimin ndaj të dëmtuarve si pasojë e këtij aksidenti, ka të drejtë që të kërkoj rimbursimin e shumës së paguar në bazë të nenit 14 par.1, pika 1.2 (Ligji nr.04/L-018), e cila shprehimisht parashihet së „I siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimeve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit”. Si dhe nenit 14 par.3(Ligji nr.04/L-018) i cili shprehimisht parashihet së „Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese”.

Gjykata, me rastin e vendosje ka vlerësuar të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, me çka ka adhur në përfundim se i padituri mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar në aksidentin e trafikut të dt....., pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-Përgjegjësia, gjegjësisht shkelje të nenit 14 par.1, pika 1.2, me të cilën dispozitë vërtetohet fakti se i padituri G., si drejtuesi nuk ka pasur leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, ky fakt rezultoi si i provuar në këtë çështje juridiko kontestimore, andaj për këtë arsye i padituri e ka humbë mbulesën siguruese, lidhur me aksidentin e lartcekur, me çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

E duke ju referuar dispozitës së nenit 7 të LPK-së, palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjithat faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK-së, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë t'i provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Meqenëse i padituri G., nuk e ka argumentuar të kundërtën e dëmit të pretenduar, gjykata e vënë para një situatë të tillë dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike, erdhi në përfundim dhe vërtetë se ekziston detyrimi, ndaj paditëses për rimbursimin e dëmit, në shumën prej 2.646€, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 245 par.1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet të Detyrimeve, i cili shprehimisht parasheh „*Kreditori në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij*”, dhe si rezultat i kësaj paditësjë ka paguar në tërësi dëmin që e ka shkaktuar i padituri, me ç'rast i padituri ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësen, në të cilin raport paditësjë e ka cilësinë e kreditorit, kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit.

Vendimin për kamatë gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ngase konsideron se nga momenti i nxjerrjes së aktgjykimit pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, me arsyetim se nga ky moment i padituri kupton për llojin dhe vëllimin e dëmit të shkaktuar palës paditëse.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së, dhe atë paditurin të detyron që në emër të shpenzimeve dhe atë: për taksën gjyqësore të paguaj shumën prej 40€.

Mbi bazën e të lartshënuarave u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-C.nr.2151/21, me dt.12.12.2024

G j y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

KËSHILLË JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykatë.